

Një palestinez është vrarë nga të shtënat e forcave izraelite në Rripin e Gazes, raporton Anadolu Agency (AA).

Ky është incidenti i parë që ka ndodhur në tre muajt e fundit që kur Izraeli dhe grupet palestineze të rezistencës arritën një marrëveshje për armëpushim në enklavën e rrethuar palestineze.

32 vjeçari Fadil Halawa u qëllua nga ushtari izraelit në Gazën Veriore. bëri të ditur zëdhënësi i Ministrisë së Shëndetësisë Ashraf al-Qodra.

Ushtria e Izraelit ende nuk ka komentuar ngjarjen.

Marrëveshjen e armëpushimit ndërmjet dy palëve u arrit më 26 gusht në Kajro, me të cilën ka përfunduar ofenziva izraelite në Rripin e Gazës.

Në sulmet e forcave izraelite që zgjatën nga 7 korriku, janë vrarë 2.160 palestinez, shumica civilë, ndërsa mbi 11.000 të tjerë janë plagosur.